



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE/
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

Më datë 12.12.2025

Kryetari i Komunës, pas shqyrtimit të konkursit me Nr. 850, të datës 08.08.2025 dhe dokumentacionit të ndërlidhur me këtë proces, bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale me Nr.03/L-040, nenin 53, nenin 54, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative me Nr. 05/L-031, merr:

V E N D I M

1. **Anullohet** Konkursi me Nr. 850 i datës 08.08.2025, për moszbatim të Ligjit për Zyrtaret Publik dhe Ligjit me Nr. 08/L-332 për Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, i shpallur për pozitën si në vijim:
 - 1.1. Vozitës, 2 pozita;
 - 1.2. Higjienistë, 3 pozita;
 - 1.3. Mirëmbajtës/punëtorë teknik 1 pozitë;
 - 1.4. Punëtor i sigurimit 1 pozitë;
2. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit, nga Kryetari i Komunës.

A r s y e t i m

Nga Komuna e Fushë-Kosovës – Kryetari i Komunës nga mandati zgjedhor 2021-2025 është shpallur konkursi me Nr.850, i datës 08.08.2025 për pozitën: Vozitës, 2 pozita; Higjienistë, 3 pozita; Mirëmbajtës/punëtorë teknik 1 pozitë; Punëtor i sigurimit 1 pozitë;

Kryetari i Komunës pas shqyrtimit të Konkursit me Nr. 850 të datës 08.08.2025 dhe dokumentacionit përcjellës i ndërlidhur me këtë proces, konstaton se:

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës ka marrë Vendimin me Nr. .68 të datës 25.07.2025 për aprovimin e Kërkesës me Nr. 627 të datës 17.06.2025 nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për shpalljen e vendeve të reja të punës dhe ndarjen e mjeteve buxhetore në shumë prej 367,144.80€ për vitin 2026 për këto shpallje. Pas marrjes së vendimit nga Kuvendi i Komunës, vendimi është dërguar për shqyrtim e ligjshmërisë në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, e për të cilin Vendim deri më datën 12.12.2025 nuk kemi pranuar përgjigjeje për shqyrtimin e ligjshmërisë brenda afatit prej 30 ditëve, konform nenit 82 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale me Nr 03/L-040. Duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë e Kuvendit të Komunës të përcaktuara në nenin 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale me Nr. 03/L-040, në nenin 27 të Statutit të Komunës me Nr. 98 të datës 17.08.2012, konstatohet se nuk është nënë

përgjegjësinë e Kuvendit të Komunës shpallja e vendeve të reja të punës dhe lejimi i mjeteve financiare në shumë prej 367,144.80€ për vitin 2026 për punësimet e punëtorëve shëndetësorë, mirëpo detyrë dhe përgjegjësi e Kuvendit të Komunës është miratimi i projeksioneve buxhetore për se cilën kategori të shpenzimeve publike. Po ashtu në bazë të dokumentacionit përcjellës konstatohet se Konkursit me Nr. 850 të datës 08.08.2025 për shpalljen e vendeve të punës në shëndetësi është edhe në kundërshtim me pikën 1 dhe 2 të Vendimit me Nr. 68 të datës 25.07.2025, sepse Vendimi i Kuvendit parasheh kryerjen e procedurave në vitin 2026, dhe jo në vitin 2025 ashtu si është shpallur konkursi me Nr. 850 të datës 08.08.2025, duke krijuar mospërputhje ndërmjet kohës së procedimit dhe afateve buxhetore të aprovuara.

Gjithashtu, nga analizimi i Planit të Personelit dhe Ligjit me Nr. 08/L-332 për Ndarjet Buxhetore për vitin 2025, konstatohen se pozitat e shpallura nuk janë të aprovuar zyrtarisht në buxhet për vitin 2025, duke krijuar pamundësi financiare dhe juridike për procedimin e mëtejshëm të procesit të rekrutimit. Po ashtu nga verifikimi i dokumentacionit në lidhje me këtë çështje verifikohet se nuk është zbatuar edhe neni 95, i Ligjit për Zyrtares Publik me Nr. 08/L-197 dhe dispozitave të Rregullores 27/ 2024 për Procedurën e konkurrimit për nëpunësit teknik dhe mbështetës, sepse kompetent për shpalljen e konkurseve, organizimin e rekrutimeve dhe procedurave tjera edhe për nëpunësit teknik dhe mbështetës është Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore brenda institucionit.

Andaj Kryetari i Komunës duke u bazuar në atë që u cek më lartë vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi

Këshilla juridike: Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtë ankese në Inspektoratin e Punës në afat prej 30 ditëve nga dita e publikimit të vendimit në sistemin e SIMBNJ dhe në web-faqen zyrtare të Komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Drejtores së Drejtorisë për Shëndetësi, Drejtorit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, NJMBNJ dhe Arkivit.

Kryetari i Komunës
Valon Prebreza

